



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

NR. ____ prot
19.12.2018

Data

Për:BO.“Hito 94“shpk dhe “Riviera“shpk

Procedura e prokurimit:Procedura e hapur

Numri i referencës së procedurës/lotit:89909-10-15-2018

Përshkrim i shkurtër i kontratës:“**Sistemim asfaltim i rrugeve te Bashkise Permet dhe te Njesive Administrative“**

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike **NR.42 DATE 22.10.2018**

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: **çmimi më i ulët X** oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1.BO “Hito 94”shpk dhe “Riviera”shpk perkatesisht me Nipte J69102206O dhe J66903244D

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera 78 926 837 (shtatedhjetë e tete milion e nentëqind e njetëzete e gjashtë mijë e teteqind e tridhjetë e shtatë)leke pa TVSH.

2.BO.B-93 dhe B-93 II perkatesisht me NIPTE J62903508R dhe L52209050O

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera 63 606 650(gjashtedhjetë e tre milion e gjashtëqind e gjashtë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë)leke pa TVSH.

3.Operatori ekonomik 4A-M me NIPT K92005016L

Vlera 61 970 478(gjashtedhjetë e një milion e nentëqind e shtatedhjetë mijë e katerqind e shtatedhjetë e tete)leke pa TVSH.

4.Operatori ekonomik “Eurostil”shpk me NIPT J99016203O

Vlera 79 213 214 (shtatedhjetë e nente milion e dyqind e trembedhjetë mijë e dyqind e katermbedhjetë)leke pa TVSH.

5.Sulo Ndertim Prodhim me NIPT L43027201P

Vlera 79 126 225(shtatedhjetë e nente mijë e njëqind e njetëzete e gjashtë mijë e dyqind e njetëzete e pese)leke pa TVSH.

6.Operatori ekonomik “Kevin Konstruksion”shpk me NIPT K71401004W

Nuk ka paraqitur oferte dhe asnje dokument per kete procedure.

7.Operatori ekonomik “Shendelli”shpk me NIPT K7924803N

Nuk ka paraqitur oferte dhe asnje dokument per kete procedure.

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1.BO.B-93 dhe B-93 II perkatesisht me Nipte J62903508R dhe L52209050O

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera 63 606 650(gjashtedhete e tre milion e gjashtëqind e gjashtë mije e gjashtëqind e pesëdhjetë)leke pa TVSH.

B.O. “B-93 II”shpk &”B-93”shpk, ne daten 07.12.2018 ka derkuar kerkesen me nr.128 prot,protokolluar ne zyren e administrates se Bashkise Permet nr.3110prot,date 07.12.2018,ku terheqje nga gara e kesaj procedure per arsye te angazhimeve te ketij operatori ne kontrata te tjera publike. Ne keto kushte KVO nderpret proceduren e vleresimit per kete operator ,pasi B.O. “B-93 II”shpk &”B-93”shpk,u terhoq nga gara e ketij tenderi, sipas njoftimit te derguar ne A.K.Bashkia Permet .Referuar Ligjit 44/2015 "Kodi i Proc. Administrative i Rep. Shqiperise", neni 94. "Terheqja e kerkeses apo braktisja e procedures",pika 1 “Si rregull ne procedure administrative te nisur me kerkesë,organi publik deklaron perfundimin pa nje vendim perfundimtar per ceshtjen nese pala qe ka paraqitur kerkesë e terheq ate”.

Per sa siper KVO ,pas njoftimit per kete terheqje,e skualifikon oferten e operatorit B.O. “B-93 II”shpk &”B-93”shpk

2.Operatori ekonomik 4A-M me NIPT K92005016L

Vlera 61 970 478(gjashtedhete e nje milion e nenteqind e shtatedhete mije e katerqind e shtatedhete e tete)leke pa TVSH.

Ne vijim te procedures se vleresimit nga KVO ne A.K.bashkia Permet ,O.E. “4A-M”shpk,me dt.06/12/2018 ka derguar neprmjet sistemit te APP dhe me shkrese zyrtare drejtuar A.K. bashkia Permet me nr.3110 prot date 07.12.2018,njoftimin e tij per terheqje nga gara e kesaj procedure . Ne keto kushte KVO nderpret proceduren e vleresimit per kete operator ,pasi O.E. "4A-M",u terhoq nga gara e ketij tenderi, sipas njoftimit te derguar ne A.K.Bashkia Permet .Referuar Ligjit 44/2015 "Kodi i Proc. Administrative i Rep. Shqiperise", neni 94. "Terheqja e kerkeses apo braktisja e procedures",pika 1 “Si rregull ne procedure administrative te nisur me kerkesë,organi publik deklaron perfundimin pa nje vendim perfundimtar per ceshtjen nese pala qe ka paraqitur kerkesë e terheq ate”.

Per sa siper KVO ,pas njoftimit per kete terheqje,e skualifikon oferten e operatorit “4A-M” shpk

3.Operatori ekonomik “Eurostil”shpk me NIPT J990162030

Vlera 79 213 214 (shtatedhjetë e nente milion e dyqind e trembedhjetë mijë e dyqind e katërmbedhjetë)leke pa TVSH.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga - O.E.”Eurostil”shpk,KVO, konsideron dhe vlerëson si më poshtë:

1- Nuk ka arritur të plotësojë me dokumentacion ,për të vertetuar se plotëson kërkesat e vecanta të A.K. për pikën 2.3kapaciteti teknik, pika 1,germa a dhe b ,për punët e ngjashme. Nga ky operator nuk është paraqitur asnjë dokument për të vertetuar se ka kryer punë të ngjashme sic është kërkuar nga A.K. në këtë pikë.

2- Nuk ka paraqitur dokumentacion për të vertetuar se në stafin e këtij O.E. ka mjek,sipas kërkesës së A.K ,pika 6 ku është kërkuar një mjek,me kontratë punë,në zbatim të VKM nr. 692, datë 13/12/2001.,paragrafi 12/2.

3- Vertetimi. i OSHE-se,i paraqitur nga ky O.E nuk është sipas kërkesës së përcaktuar NE vkm NR.379 datë11/06/2014,”Për disa shtesa e ndryshime në VKM nr. 1 datë 10.01.2017,”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, I ndryshuar,pasi në vertetimin e paraqitur nuk përfshihen detyrimet e maturuara për energjinë elektrike të shpenzuar nga O.E. sic është kërkuar nga A.K. Vertetimi I paraqitur prej tij përfshin muajin korrik 2018 kur në fakt detyrimet e maturuara për procedurë e këtij prokurimi përfshijnë dhe muajin shtator 2018.Në këtë kushtë kjo pikë e kërkuar nga A.K. nuk plotësohet dhe përben shkak për skualifikim.

4-O.E. “Eurostil”shpk nuk plotëson kategoritë e licencës të shoqërisë sipas kërkesës së A.K. në D.T dhe njoftimin e kontratës. Në pikën 2.3. kapaciteti teknik ,pika 2 është kërkuar Licenca profesionale .lidhur me ekzekutimin e punimeve, germa a Licenca e shoqërisë e vlefshme për kategoritë e mëposhteme: NP -1A; NP-4C;NS-18A. “Eurostil”shpk nuk zotëron kategorinë e licencës për NP-4C dhe NS18A. Mos plotësimi dhe I kesaj kërkesë përben shkak për skualifikim.

Në nenin 46, pika 1 e ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen,pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese”;

Në nenin 53/3 të LPP-së parashikohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”

Për sa më sipër, KVO , bazuar në LPP e RRPP,vendos skualifikimin e ofertes së O.E. “Eurostil” shpk ,pasi ajo nuk i përmbush të gjitha kërkesat e A.K.për realizimin e

kontrates per kete procedure prokurimi.

4.Sulo Ndertim Prodhim me NIPT L43027201P

Vlera 79 126 225(shtatedhete e nente mije e njeqind e njezete e gjashte mije e dyqind e njezete e pese)leke pa TVSH.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit te paraqitur nga

O.E.“Sulova ,Ndertim,Prodhim”shpk,KVO, konsideron dhe vlereson si me poshte:

1- Nuk ka arritur te plotesoje me dokumentacion ,per te vertetuar se ploteson kerkesat e vecanta te A.K. per piken 2.3 kapaciteti teknik, pika 1,germa a dhe b ,per punet e ngjashme. Nga ky operator nuk eshte paraqitur asnje dokument per te vertetuar se ka kryer pune te ngjashme sic eshte kerkuar nga A.K. ne kete pike.

2-Nuk ka paraqitur dokumentacion per te vertetuar se ne stafin e ketij O.E. ka mjek,sipas kerkeses se A.K,pika 6, ku eshte kerkuar nje mjek,me kontrate pune,ne zbatim te VKM nr. 692, date 13/12/2001,paragrafi 12/2.

3-Vertetimi. i OSHE-se,i paraqitur nga ky O.E nuk eshte sipas kerkeses se percaktua NE vkm NR.379 date11/06/2014,”Per disa shtesa e ndryshime ne VKM nr. 1 date 10.01.2017,”Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, I ndryshuar,pasi ne vertetimin e paraqitur nuk perfshihen detyrimet e maturuara per energjine elektrike te shpznuar nga O.E. sic eshte kerkuar nga A.K. Vertetimi I paraqitur prej tij perfshin muajin korrik 2018 kur ne fakt detyrimet e maturuara per procedure e ketij prokurimi perfshijne dhe muajin shtator 2018.Ne keto kushte kjo pike e kerkuar nga A.K. nuk plotesohet dhe perben shkak per skualifikim.

4-O.E. .“Sulova ,Ndertim,Prodhim”shpk, nuk ploteson kategorite e licences te shoqerise sipas kerkeses se A.K. ne D.T dhe njoftimin e kontrates. Ne piken 2.3. kapaciteti teknik ,pika 2 eshte kerkuar Licenca profesionale .lidhur me ekzekutimin e punimeve, germa a Licenca e shoqerise e vlefeshme per kategorite e meposhteme: NP -1A; NP-4C;NS-18A. O.E.i mesiperm, nuk zoteron kategorine e licences per kategorine NP-4C. Mos plotesimi dhe i kesaj kerkese perben shkak per skualifikim.

5.Nuk ploteson kerkesen e AK,Kapaciteti teknik, pika 12,deshmi per mjetet dhe paisjet ne dispozicion...qe I nevojiten per realizimin e kontrates.Nuk ka paraqitur dokumentacion per plotesimin e kesaj kerkese.

Në nenin 46, pika 1 e ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen,pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese”;

Në nenin 53/3 të LPP-së parashikohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”

Per sa me siper, KVO , bazuar ne LPP e RPPP,vendos skualifikimin e ofertes se O.E.“Sulova ,Ndertim, Prodhim”shpk ,pasi ajo nuk i pambush te gjitha kerkesat e A.K.per realizimin e kontrates per kete procedure prokurimi.

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë *bashkimin e operatoreve ekonomik “HITO 94”shpk dhe “RIVIERA”shpk* se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej 78 926 837 (shtatedhjete e tete milion e neteqind e njezete e gjashte mije e teteqind e tridhjetë e shtate)leke pa TVSHështë identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë *Bashkise Permet me adrese sheshi “Abdyl Frasheri”kati i katert per sigurimin e kontratës*, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 ditëve nga dita e publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës do të veprohet, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 11.12.2018

Ankesa: nuk ka



TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR
NIKO SHUPULI